

1.3.1	B-complex
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

B-complex film tableta të mbështjellura

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërin me kujdes sepse përmban informata të rëndësishme për ju.

Ky bar është në dispozicion pa recetë. Megjithatë, ju duhet të merrni B-complex me kujdes për të përfituar rezultatet më të mira prej tij.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje ose kërkoni këshilla të tjera, drejtohuni farmacistit.
- Duhet t'a kontaktoni mjekun nëse simptomat tuaja përkeqësohen ose nuk përmirësohen pas 14 ditësh.
- Nëse cildo nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është B-complex dhe për se përdoret
2. Para se të merrni B-complex
3. Si të merrni B-complex
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani B-complex
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË B-COMPLEX DHE PËR SE PËRDORET

B-complex përmban grupin e vitaminave B që stimulojnë metabolizmin e karbohidrateve, yndyrave dhe proteinave. Mungesa e ndonjërës prej këtyre vitaminave ose shpenzimi i shtuar i tyre, rrisin gjithashtu nevojën për vitamina tjera nga ky grup. Prandaj, nëse paraqiten shenjat e mungesës të cilitdo vitamin nga grupi B, duhet marrë tërë kompleksin e vitaminave B.

B-complex përdoret:

- për parandalimin dhe trajtimin e mungesës së pjesërishme të vitaminave të grupit B (hipovitaminoza B dhe avitaminoza B),
- kur është shtuar shpenzimi (nevoja) për vitaminat e grupit B,
- kur është çrregulluar resorbimi i vitaminave tek sëmundjet gastrointestinale dhe sëmundja e mëlçisë,
- te sëmundja e quajtur beriberi (hipovitaminoza për shkak të mungesës së tiaminës), neuralgjia (dhimbje e cila paraqitet te sëmundja e nervave periferike), polyneuritis (sëmundje e disa nervave), neurodermatosis (sëmundje e nervave të lëkurës).

2. PARA SE TË MERRNI B-COMPLEX

Mos merrni B-complex

- nëse jeni alergjik në vitaminat B-complex ose në ndonjë përbërës tjetër të këtij bari (të listuara në seksionin 6).
- nëse keni hipervitaminozë të ndonjërit nga vitaminat.
- nëse jeni të ndieshëm ndaj kobaltit.

1.3.1	B-complex
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



Tregoni kujdes të veçantë me B-complex

Bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin para se të merrni B-complex.

Gjatë përdorimit të vitaminës B-complex, ngjyra e urinës mund të jetë e verdhë për shkak të riboflavinës. Mund të paraqiten reaksionet e ndjeshmërisë.

Lajmëroni mjekun nëse keni nga ndonjë sëmundje kronike ose çrregullimi i metabolizmit.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barna që merren pa recetën e mjekut.

Nëse B-complex merret së bashku me barin levodopa, efekti i barit levodopa mund të zvogëlohet (për shkak të piridoksinës).

Përdorimi afatgjatë i barnave antimikrobe të cilat e ndryshojnë florën e zorrëve, dhe me këtë edhe resorbimin, shkaktojnë mungesën e vitaminave të grupit B.

Marrja e B-complex me ushqim dhe pije

Ushqimi dhe pijet nuk kanë ndikim në resorbimin e tabletave të mbështjellura B-complex.

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Nëse jeni shtatzënë ose ushqeni foshnjën tuaj me gjë, mendoni që mund të bëheni shtatzënë ose planifikoni të keni foshnjë, bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin para se ta merrni këtë bar. Shtatzënat dhe gratë të cilat ushqejnë fëmijët me gjë mund të marrin tabletat e mbështjellura B-complex.

Ngasja dhe përdorimi i makinerive

Tabletat B-complex nuk kanë ndikim në aftësinë për vozitje dhe përdorimin e makinave.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e B-complex

B-complex përmban laktozë, natrium dhe etanol.

Nëse mjeku ju ka thënë se keni intolerancë në ndonjërin prej sheqereve, kontaktoni mjekun tuaj para se ta merrni këtë bar.

Ky bar përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) për dozë, respektivisht në esencë është “pa natrium”.

Ky bar përmban sasi të vogla të etanolit (alkoolit), më pak se 100 mg për dozë.

3. SI TË MERRET B-COMPLEX

Gjithmonë merrni B-complex saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Doza e zakonshme është:

Doza e rekomanduar për të rriturit është 1 deri 2 film tableta të mbështjellura 2 deri 3 herë në ditë.

Përdorimi te fëmijët dhe adoleshentët

Fëmijët prej 5 deri 14 vjeç duhet të marrin 1 film tabletë të mbështjellur në ditë.

Tableta duhet të gëlltitet me lëngje.

1.3.1	B-complex
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



Nëse keni përshtypjen se efekti i këtij bari është shumë i fort ose shumë i dobët, bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin.

Nëse merrni B-complex më shumë se ç'duhet

Nëse keni marrë doza më të mëdha të këtij bari se sa ka qenë e nevojshme, konsultoni mjekun tuaj ose farmacistin.

Marrja afatgjate e dozave të cilat janë shumë më të mëdha se sa ato të rekomanduara mund të shkaktojë kokëdhimbje, acarim, pagjumësi, dridhje dhe diarree.

Nëse harroni të merrni B-complex

Mos merrni dozë të dyfishtë për ta kompensuar dozën e harruar.

Nëse e ndërprisni marrjen e B-complex

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtohuni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, B-complex mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë paraqiten ato.

Efektet e padëshiruara shumë të rralla (mund të paraqiten tek 1 në 10,000 njerëzi): kokëdhimbja, shikimi i paqartë, marramendja, diarrea, të vjella, të përziera, inflamacioni i lëkurës (dermatitis), reaksionet e ndjeshmërisë.

Paraqitja e efekteve anësore

Nëse ju paraqitet çfarëdo efekti anësor, duhet që të lajmëroni mjekun ose farmacistin. Kjo përfshin çdo efekt anësor që nuk është dhënë në këtë fletudhëzim. Efektet anësore mund të paraqiten drejtpërsëdrejti nëpërmjet sistemit nacional të raportimit. Me paraqitjen e efekteve anësore mund të ndihmoni në vlerësimin e sigurisë së këtij bari.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET B-COMPLEX

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

Mos e përdorni B-complex pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Të ruhet në temperaturë deri në 25°C.

Ruajeni në paketim origjinal të mbrojtur nga lagështia.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave shtëpiake. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta ruajtur mjedisin.

1.3.1	B-complex
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban B-complex

- Substancat aktive janë vitaminat B-complex. 1 film tabletë e mbështjellur përmban 4 mg tiamin hidroklorur (thiamini hydrochloridum), 5 mg riboflavin (riboflavinum), 2 mg piridoksin hidroklorur (pyridoxini hydrochloridum), 1 mikrogram cianokobalamin (cyanocobalaminum), 5 mg pantotenat të kalciumit (calcii pantothenas) dhe 25 mg nikotinamid (nicotinamidum).
- Përbërësit e tjerë janë povidon K25, acid limoni, monohidrat laktoze, niseshte misri, celulozë mikrokristalore, talk, stearat magnezi, maltodekstrinë dhe trinatrium citrat në bërthamën e tabletës dhe poli(vinil alkool), dioksid titani (E171), talk, makrogol 3350, oksid i zi hekuri (E172), oksid i verdhë hekuri (E172) dhe oksid i kuq hekuri (E172) në film mbështjellësin. Shihni seksionin 2 “B-complex përmban laktozë, natrium dhe etanol”.

Si duket B-complex dhe përbërja e paketimit

Film tabletat e mbështjellura janë ngjyrë të kaftë të errët, të rrumbullakëta, lehtë bikonvekse me skaje të lakuara. Diametri i tabletës: afërsisht 8 mm.

Tabletat B-complex gjenden në kutitë prej 30 (2 x 15) dhe 60 (4 x 15) film tableta të mbështjellura në blistera.

Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet pa recetë të mjekut.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

tel: +386 7 331 28 84,

fax: +386 7 332 27 42

www.krka.si

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në 03/2023.